

RAPORT PËRMBLEDHËS PËR BATAJNICËN

AKTIVITETET MONITORUESE TË MJEKËSISË
LIGJORE

EKSHUMIMET DHE EKZAMINIMET

**RAPORT PËRMBLEDHËS MBI AKTIVITETET MONITORUESE TË MJEKËSISË LIGJORE
LIDHUR ME GËRMIMIN DHE MBLEDHJEN E MBETJEVE MORTORE NË DISA LOKACIONE TË
NDËRLIDHURA ME**

BATAJNICËN

**Serbi dhe Mal i Zi
Gusht – Dhjetor 2002**

1. Përmbledhje e ekshumimeve të monitoruara nga ICMP gjatë vitit 2002 në Batajnicë

1. Gjatë viteve 2001-2002, në terrenin për trajnime të policisë anti-terroriste (SAJ) në Batajnicë, rrethinë e Beogradit, Serbi dhe Mal i Zi (SCG), një seri prej pesë varrezave masive dhe tri elementeve që lidhen me to janë hulumtuar nga ekspertë të emëruar nga gjykata. Në vitin 2001, antropologu i lartë i ICMP-së për mjekësi ligjore Dr. Mark Skinner ka vëzhguar gërmimet e Batajnicës 01 dhe 02. Dr. Skinner ka siguruar një raport përmbledhës, i cili është shpërndarë vitin e kaluar, ku paraqiten të gjitha hulumtimet që ICMP i ka monitoruar në Serbi, përfshirë BA01 dhe BA02. Ky raport i tanishëm, sikurse edhe raporti i Dr. Skinner ...

“...ka për qëllim që t’u njoftojë opinionin e interesuar, përfshirë edhe shoqatat e ndryshme familjare, në lidhje me natyrën e këtyre lokacioneve, përmbajtjet e tyre, metodat e përdorura për të ekshumuar mbetjet mortore dhe dëshmitë e tjera, si dhe gjetjet themelore. Ky nuk është një dokument ligjor dhe nuk reflekton këndvështrimet apo gjetjet e agjencive qeveritare apo institucioneve të mjekësisë ligjore të përfshira në ekshumimet, nga të cilat pritet t’i lëshojnë deklaratat e tyre.”

Skinner, Përmbledhje 2001

2. Ky raport përmbledhës pasqyron gërmimet e bëra në Batajnicë gjatë vitit 2002 dhe përmban informata mbi varrezat masive BA03, BA05 dhe BA07, dhe elementeve që lidhen me to BA04, BA06, dhe BA08. Për informata lidhur me gërmimet dhe ekzaminimet e mbetjeve mortore të gjetura në BA01 dhe BA02, ju këshillojmë që të referoheni tek raporti i Dr. Skinner, i vitit 2001 ‘Përmbledhje e ekshumimeve të monitoruara nga ICMP në Serbi’.

2. Informata rreth lokacionit

3. Ky raport përshkruan hulumtimet mjeko-ligjore të vitit 2002 të një numri të varrezave masive dhe elementeve të tjera që lidhen me to që janë gërmuar me anë të makinave, të cilat janë kryer nga instituti i mjekësisë ligjore të Beogradit (FIB), dhe arkeologëve/antropologëve të Komisionit Ndërkombëtarë për Persona të Zhdukur (ICMP). Puna është inicuar me urdhër të Gjykatës së Qarkut të Beogradit dhe është kryer midis 20 qershorit dhe 16 dhjetorit të vitit 2002. Kjo punë është kryer sipas rregullave të dhëna nga Gjykata e Qarkut e Beogradit dhe ka paraqitur fazën përfundimtare të gërmimeve përbrenda policisë anti-terroriste (SAJ), e vendosur në kazermën e MUP-it në Batajnicë, në veri-perëndim të Beogradit (Figura 1).
4. Autoriteti dhe përgjegjësia e plotë për gërmimet dhe autopsitë e kryera në vendin e ngjarjes i kanë takuar Gjykatës së Qarkut të Beogradit dhe jo ICMP-së. Sidoqoftë, një marrëveshje lidhur me gërmimet e varrezave masive gjatë vitit 2002 është arritur midis Gjykatës së Qarkut dhe ICMP-së, e cila i ka lejuar arkeologët dhe antropologët e mjekësisë ligjore të ICMP-së të ndihmojnë në gërmimet e atëhershme, të përkrahur nga një ekip i arkeologëve vendas (individët e njejtë që kanë punuar në BA01 në vitin 2001). Sa i përket autopsive të mbetjeve mortore të cilat janë ekshumuar, ICMP-ja nuk i ka mbikqyrur apo ndihmuar ato autopsi, por vetëm ka siguruar monitorim në vendin e ngjarjes. Gjykata e Qarkut e Beogradit ka mbajtur të gjitha raportet e autopsive. Mostrat e eshtrave dhe dhëmbëve të marrura gjatë autopsive janë dorëzuar në ICMP ku tani ato janë duke i’u nënshtruar analizave të ADN-së.
5. Janë ndërmarrur kërkime të zonës në tërësi për të identifikuar dhe gërmuar të gjitha elementet e varrezave të supozuara që mund të përmbanin të mbetura mortore të viktimave të supozuara të konfliktit të Kosovës, të vitit 1999. Zona për të cilën është menduar që i përmban këto varreza shtrihej në teritorin e SAJ-it, dhe kryesisht përbënte pjesën më veriore, e vendosur në gjatësi prej 300 metrave në drejtim të lindjes. Gërmimi ka filluar nga një program me heqjen e kontrolluar të shtresës së lartë të dheut, për të zbuluar skajet e elementeve brenda në lokacion. Pas përfundimit të ekshumimeve IML po ashtu ka kryer mbikqyrjen mekanike të heqjes së dheut nën depot e dedikuara për autopsi dhe vendvendosjen e përkohshme të mbetjeve mortore, për të siguruar se të gjitha lokacionet janë gjetur.

3. Përmbledhje e informatave dhe gjetjeve

6. Listat e mëposhtme tregojnë datat kur janë realizuar gërmimet në Batajnicë, numrin e mbetjeve mortore të ekshumuara, dhe numrin e lëndëve të rëndësishme mjeko ligjore të gjetura ose të regjistruara gjatë gërmimeve. Në këto lista janë të përfshira edhe informatat e gërmimeve të vitit 2001 (BA 01 dhe BA 02).
7. Është e domosdoshme të bëhet një sqarim i kësaj përmbledhjeje. Së pari, kufomat e gjetura në varrezat masive në Batajnicë u janë nënshtruar një lloj traume që ka rezultuar në vdekjen e tyre. Së dyti, derisa ndodhte procesi natyror i shpërbërjes, disa nga mbetjet mortore të ekshumuara janë gjetur edhe në gjendje të djegur, dhe në disa raste në kufoma janë shkaktuar dëmtime të konsiderueshme nga makina(t) për ndërtim të cilat janë përdorur për krijimin e varrezave masive. Kombinimi i këtyre faktorëve ka rezultuar që në shumë mbetje mortore të ekshumuara të mungojnë pjesë të kufomës. Të gjitha kufomat, pjesët e kufomave, dhe dëshmitë e bashkuara janë gërmuar, mirepo ribashkimi i sërishëm i pjesëve të kufomave me kufomat e tyre është një punë që do të zgjidhet nëpërmjet analizave të ADN-së, dhe punës së antropologëve mjeko ligjorë.




Figura 1:
Lokacioni i përafërt i kazermeve të MUP-it në Batajnicë

8. Si rezultat, numri i kufomave për të cilat bëhet fjalë në këtë raport bazohet në të gjeturat antropologjike të numrit minimal të individëve (NMI), të raportuar nga IML-ja. Numri i pjesëve të mbledhura të kufomave nuk është i shënuar këtu dhe ekziston mundësia, edhe pse shumë e vogël, që nga mbledhja e pjesëve të ndryshme të kufomave, përmes analizave të ADN-së, të ndahen edhe pjesë tjera shtesë të kufomave.

9. Numri i lëndëve të rëndësishme mjeko ligjore që janë nxjerrë apo regjistruar është bazuar në të dhënat e incizimeve teknike arkeologjike gjatë nxjerrjes së tyre nga varreza. Lëndët shtesë, të gjetura gjatë autopsive nuk paraqiten në këtë listë. Për shkak të faktit se gjatë gërmimeve të vitit 2001 kanë qenë të pranishëm vetëm antropologët e ICMP-së, e jo edhe arkeologët, ICMP nuk posedon të dhëna lidhur me lëndët e gërmuara gjatë atij viti.

<u>Lokacioni</u>	<u>Datat e gërmimeve</u>
BA01	2 Qershor – 26 Qershor 2001
BA02	10 Korrik – 21 Shtator 2001
BA03	20 Qershor – 26 Korrik 2002
BA04	30 Korrik - 2 Gusht dhe 5 - 6 Shtator 2002
BA05	2 Gusht – 26 Nëntor 2002
BA06	19 Gusht - 2 Shtator 2002
BA07	4 Nëntor - 16 Dhjetor 2002
BA08	21 Nëntor - 26 Nëntor 2002

Kufomat e plota të ekshumuara gjatë gërmimeve (të dhënat e vëzhguesve)

<u>Lokacioni</u>	<u>Nr. i Kufomave</u>
BA01	36
BA02	269
BA03	39
BA04	0
BA05	287
BA06	0
BA07	74
BA08	0
Total	705

Lëndët e mbledhura me rëndësi për mjekësinë ligjore (bazuar në incizimet teknike)

<u>Lokacioni</u>	<u>Nr. i pjesëve</u>
BA01	i panjohur
BA02	i panjohur
BA03	112
BA04	5
BA05	187
BA06	23
BA07	46
BA08	7
Total:	380

4. Përmbledhje për gërmimet e vitit 2002 sipas lokacioneve

10. Lokacionet BA 03 – BA 08 janë gërmuar gjatë vitit 2002. BA 03, BA 05 dhe BA 07 ishin varreza masive. BA 04, BA 06 dhe BA 08 ishin elemente që lidhen me varrezat masive, por jo varreza masive në vete. Sidoqoftë, BA 06 dhe BA 08 përmbanin një numër të vogël të pjesëve të kufomave. Harta e mëposhtme tregon pozitën ndërlidhëse të varrezave masive dhe elementeve, të cilat janë gërmuar gjatë vitit 2001-2002. (Figura 2). Meqë asnjë arkeolog i ICMP-së nuk ishte prezent gjatë vitit 2001 që ti regjistronte lokacionet e sakta, pozitat e varrezave BA 01 dhe BA 02 janë të përafërta.

11. Detyra arkeologjike e locimit dhe mbledhjes së mbetjeve mortore, si dhe të lëndëve është ndërmarrur nëpërmjet të emëruarit të lartë të ICMP-së, arkeologut z. Xhon Sterenbergut (Jon Sterenberg) dhe antropologut të lartë të ICMP-së dr. Mark Skinner-it (BA 01, BA 02, dhe BA 03). Një ekip i vogël i përbërë prej katër arkeologëve të kualifikuar vendas nga Universiteti i Beogradit ishin punësuar nga ICMP-ja për të ndihmuar në gërmimet e BA 03, BA 05, dhe BA 07; tre prej tyre kanë marrë pjesë në gërmimet e BA 01 në vitin 2001. Një ekip i kombinuar i ICMP-së nën udhëheqjen e arkeologut të ICMP-së z. Hju Taller (Hugh Tuller) ka kryer gërmimet e mëvonshme në lokacionin BA 07.




Figure 2:
Plani i varrezave masive dhe elementeve në Batajnicë

12. Qëllimi i gërmimit ka qenë i katërfishtë:

- që të përcaktohet varreza duke përdorur makina dhe mjete të dorës;
- që në mënyrë të kujdesshme të ekspozojë, pastrojë, regjistrojë, dhe në mënyrë teknike të inçizojë në tri dimensione të gjitha kufomat apo dëshmitë mjeko ligjore të gjetura gjatë procesit të gërmimit duke përdorur teknikat dhe metodat arkeologjike;
- që të gjitha të mbeturat mortore dhe lëndët e rëndësishme mjeko ligjore t'i transferohen ekipit të terrenit të Institutit të Mjekësisë Ligjore (IML) për analiza të mëtutjeshme;
- po që se është e mundshme të sigurohet që i tërë vendi i gërmimit të jetë nën kontrollin e ndonjë arkeologu me përvojë në mënyrë që të zbulojë aq më shumë dëshmi sa është e mundur rreth krijimit të varrezës, vendosjes së kufomave, dhe dëmtimit ose mbushjes së sërishme të varrezës.

13. Inçizimi teknik i kufomave në tri dimensione është bërë me qëllim që të krijohen harta precize të cilat do të tregonin vendin e saktë të kufomave dhe çfarëdo dëshmi të tjera të cilat do të ishin të rëndësishme për identifikim [p.sh. dokumentet, kuletat, etj.], apo për shkakun dhe mënyrën e vdekjes [p.sh. fishekët, fragmentet e mjeteve shpërthyes etj.] brenda kontekstit të varrezës.


5. Batajnica 3 (BA 03)

5.1. Përmbledhje e gjetjeve

14. Gjithsej, nga varreza janë ekshumuar përafërsisht mbetjet mortore të 39 individëve së bashku me përafërsisht 10 komplete të dokumenteve të supozuara identifikuese.

5.2. Gërmimi

15. Një varrezë e vetme e gjatë e vendosur në tatëpjetëze me dimensione përafërsisht 16.70m e gjatë, 2.80m e gjerë dhe 2.50m e thellë, u gërmua më dorë duke përdorur teknikat arkeologjike.
16. Baza e varrezës së vendosur tatëpjetë është identifikuar në pjesën perëndimore të fundit të varrezës. Pika më e thellë e varrezës ka qenë në skajin lindor. Muret e varrezës ishin vertikale, duke i dhënë asaj një pamje në formë pyke, shikuar nga anash. Kufomat e vendosura në një mënyrë të çrregullt përgjatë skajit më të thellë të lindjes në bazën e varrezës, ku një numër më i madh i mbetjeve mortore të 39 individëve ishin të padëmtuara, shumica prej të cilave kishin dokumente shoqëruese për identifikim të supozuar. Një përqindje e madhe e mbetjeve të padëmtuara mortore janë gjetur të mbuluara me mbulesa plastike dhe në arkivole të zeza. Shumica e kufomave kishin të veshur rrobe, dhe asnjëra nga to nuk kishte veshmbathje ushtarake. Gjatë gërmimit nuk janë vërejtur lidhje të duarve apo të syve. Ky lloj i vendosjes së paprekur nuk ka shfaqur asnjë shenjë të çrregullimit pasues dhe prandaj kjo është klasifikuar si varrezë 'primare'.
17. Janë gjetur dëshmi se për ndërtimin e varrezës është përdorur një makinë e madhe shkarkuese me rrota; këto dëshmi përfshinin gjurmët e krijuara nga dhëmbët e lugës dhe rrotat e makinës shkarkuese. Veç kësaj, nga varreza është nxjerrë edhe një pjesë e madhe e kamionit.
18. Dëshmia e vënies së zjarrit të madh përbrenda varrezës në një periudhë pas vendosjes së kufomave është vërejtur në të gjitha sipërfaqet e hapura të mureve të varrezës dhe diku deri në bazë të varrezës ose tatëpjetëzës. Është vërejtur që shkatërrimi nga zjarri është shpërndarë edhe nëpër muret e varrezës në një thellësi prej përafërsisht 2 cm.
19. Veç këtyre dëshmive, nga varreza janë marrur mostra të bimëve, dheut dhe mostra entomologjike. Të gjitha dëshmitë në këtë varrezë, si dhe në të gjitha varrezat dhe elementet e tjera të gërmuara në Batajnicë janë dorëzuar në IML.




6. Batajnica 4 (BA 04)

6.1. Përmbledhje e gjetjeve

20. BA 04 nuk është varrezë, dhe nuk është gjetur asnjë dëshmi që tregon se ndonjëherë ajo është përdorur për vendosjen e mbetjeve mortore. Ky vend është një zonë e çrregulluar nga shenjat e makinave, që përmban gjurma të gomave, si dhe të gomave të deformuara që kanë qenë në togun e materialit të mbledhur në kohën kur është krijuar BA 03.

6.3. Gërmimi

21. BA 04 është identifikuar nëpërmjet gërmimit të kontrolluar si një zonë në formë të çrregulluar me dimensione përafërsisht 2 deri në 3 m nga skaji lindor i BA 03, dhe përafërsisht 6m me 6m në madhësi. Gërmimi i këtij elementi konfirmoi se aty bëhet fjalë për gjurmë të shpëtuara të çrregullimit e që lidhen me shkarkimin e materialit gërmues gjatë fazës së ndërtimit të BA 03.
22. Vlerësimi i këtij elementi tregon se këtu bëhet fjalë për veprimtari makinerike që identifikohet nga shenjat e dhëmbëve të lugës dhe gomave të mbetura aty nga trafiku i makinave të rënda. Mendohet se gjurmët i përkasin llojit të makinës-shkarkuesit për ndërtim. Përveç gjurmëve nga makina, në zonën e çrregulluar janë gjetur edhe disa goma që paraqitin shenja të deformimit përmes shtypjes. Thellësia më e madhe në këtë zonë është 36 cm. Këtu nuk kishte kufoma apo pjesë të kufomave. Pjesët e makinës siç janë dhëmbët e lugës dhe gomat janë regjistruar si vegla.



7. Batajnica 5 (BA 05)

7.1. Përmbledhje e gjetjeve

23. Gjithsej, nga kjo varrezë masive janë nxjerrur mbetje të padëmtuara mortore të rreth 287 individëve. Shumica nga individët kishin dokumente shoqëruese që mund të çojnë në identifikime të supozuara.

7.2. Gërmimet

24. Një varrezë e vetme e gjatë e vendosur në tatëpjetëze me dimensione rreth 25m gjatësi, 2.80m deri 2.90m gjerësi, dhe me një thellësi prej 1.50m deri në 2m, në skajin verior të saj, kryesisht është gërmuar me dorë, duke përdorur teknikat arkeologjike. Gjatë pastrimit fillestar, si dhe gjatë vetë gërmimit, ekipi i arkeologëve ka gjetur dëshmi të djegjes përbrenda varrezës. Dëshmitë e këtij dëmtimi nga zjarri janë konfirmuar gjatë tërë gërmimit. Goma të makinave ishin vendosur në fund dhe pak a shumë nëpër tërë varrezën me qëllim që të ndihmojnë djegjen e mbetjeve mortore. Një numër i kufomave ishte dëmtuar nga ky zjarr, disa edhe shumë rëndë.
25. Përbrenda kësaj varreze nga gjithsej trembëdhjetë shtresave të ndara të mbetjeve mortore, janë gjetur dhe regjistruar të paktën 287 persona. Asnjëra nga mbetjet mortore të gjetura nga këto shtresa nuk janë vërejtur të kenë të veshura rroba ushtarake. Gjithashtu, nga ekipi i arkeologëve në këto shtresa nuk është vërejtur apo gjetur lidhje e duarve apo syve. Sidoqoftë, disa kufoma kishin kartela të vogla plastike me numra të cilët ishin të ngjitura në jakët e rrobeve të tyre. Po ashtu interesante është që ekipi i gërmimit ka gjetur mbetjet e një arkivoli pjesërisht të paprishur në të cilin mungonte kufoma.
26. Nga mbetjet mortore ishin gjetur së paku 20 dokumente identifikuese. Këto dokumente kryesisht janë gjetur në rrobe ta palidhura, në rrobe të lidhura gjatë autopsisë ose në mbulojat e plastikës që mbështjellnin kufomat. Veç kësaj, gjatë gërmimit janë gjetur edhe një palë tespah.




Figura 3:
Depozitimi i trupit (dukja e profilit)

27. Janë gjetur dëshmi që për ndërtimin e varrezës është përdorur një makinë e madhe shkarkuese me rrota; këto dëshmi përfshinin gjurmët e krijuara nga dhëmbët e lugës së makinës shkarkuese. Gjurmët e rrotave të makinës shkarkuese janë gjetur dhe regjistruar. Gjithashtu, gjatë gërmimit janë nxjerrur edhe disa pajisje të kamionit. Veç kësaj, janë marrur edhe mostrat të dheut dhe mostrat entomologjike. Të gjitha dëshmitë u janë dorëzuar autoriteteve të Gjykatës së Qarkut të Beogradit.

8. Batajnica 6 (BA 06)

8.1. Përmbledhje e gjetjeve

28. BA 06 nuk është varrezë. Ajo është një sipërfaqe rrethore me një hapsirë prej 6 x 6m në të cilën ka pasur djegje intenzive. Një numër i vogël i mbetjeve mortore të fragmentuara dhe të djegura janë gjetur së bashku me disa fragmente të vogla të rrobeve të djegura, fragmente të drunjëve të djegur dhe të shkrumbuar, fragmente të vogla të gomave të djegura të makinave, dhe fragmente të metalit dhe qelqit.

8.2. Gërmimi

29. Një zonë në formë të çrregullt, e karakterizuar me argjilë të djegur në veri të BA 03, me një sipërfaqe përafërsisht 6x6m, është gërmuar me përdorimin e teknikave arkeologjike. I tërë materiali i nxjerrë nga ky vend shpjegon shenja dëmtuese të shkaktuara nga ekspozimi i nxehtësisë, që tregonte se në atë vend në një moment të caktuar është ndezur një zjarrë i madh. Skaji jugor i kësaj zone është skaj i drejtë si pasojë e veprimtarisë makinerike gjatë gërmimit të bërë në vitin 2001 në BA 02. Gjatë gërmimeve të vitit të kaluar në varrezën masive BA 02, ekipi mjeko ligjorë kishte krijuar një laurë mekanike për të hyrë në varrezë, në mënyrë që të mundësonte nxjerrjen e mbetjeve mortore veçmë të gërmuara. Gjatë punës së tyre në BA 02 laura kishte dalë në skajin jugor të BA 06 duke lënë në skajin jugor një vijë të drejtë në drejtim perëndim-lindje, një dukuri që për ekipin ishte e panjohur në atë moment.
30. Në këtë hapsirë janë gjetur tri pjesë të kufomave; të gjitha nga to tregonin shenja se u janë nënshtruar procesit të djegjes. Nuk është gjetur asnjë dëshmi e indeve të buta në këtë vend. Këto eshtra nuk përshatashin me njëra-tjetrën, e as nuk ndodheshin afër njëra-tjetrës, dhe ishte e pamundur të bëhet çfarëdo bashkimi i tyre.
31. Nga sipërfaqja e dukshme 'primare' janë vërejtur shenja të ndrydhjes të bëra nga dhëmbët e lugës dhe gomave të ndonjë makine të rëndë. Këto shenja tregojnë se një makinë e madhe shkarkuese ka vepruar në këtë zonë gjatë zjarrit apo menjëherë pas shuarjes së tij. Rezultatet e gërmimeve tregojnë se kufomat e djegura në këtë vend ishin ngritur nga një makinë ngarkuese dhe ishin vendosur në njërin prej varrezave të hapura masive.

9. Batajnica 7 (BA 07)

9.1. Përmbledhje e gjetjeve

32. Në përgjithësi, mbetjet mortore të rreth 47 individëve janë ekshumuar nga kjo varrezë masive e vendosur në tatëpjetëze. Po ashtu, gjatë gërmimit janë gjetur një numër i vogël i dokumenteve për identifikime të supozuara.

9.2. Gërmimet

33. Një varrezë e vetme e madhe e vendosur në tatëpjetëze me dimensione përafërsisht 14m e gjatë, 2.80m deri 2.90m e gjërë dhe me thellësi më të madhe prej 2.7m thellësi ishte identifikuar dhe gërmuar. Në këtë varrezë janë gjetur dhe regjistruar pesë shtresa të ndara me nga një numër minimal prej 74

individëve. Po ashtu, BA 07 ka treguar shenja të zjarrit përbrenda varrezës. Sidoqoftë, intensiteti i zjarrit nuk ishte aq i madh si në varrezat e tjera në Batajnicë.

34. Ndryshe nga të gjitha varrezat dhe elementet e tjera të gërmuara gjatë vitit 2002, në këtë varrezë ishte përdorur një eskavator i vogël që përbëhej nga dy lugë të lëmuara me madhësi të ndryshme. Kjo ishte bërë për shkak të kufizimeve kohore dhe kushteve klimatike. Kjo makinë për ndërtim kishte hequr dheun në një masë më të madhe se sa kishte me qenë rasti i gërmimit me dorë, kështu duke e kursyer kohën. Sidoqoftë, për shkak të gërmimit të shpejtë, ndoshta janë humbur dëshmi të caktuara të cilat do të mund të ndihmonin për të kuptuar procesin e formimit të varrezës. Megjithatë, është ndërmarrur një hulumtim gjeofizik duke përdorur rezistencën, në mënyrë që të nxirren prerje të thella lineare të painvazuara ose elektronike në lokacionin e dyshuar. Rezultatet i kanë mundësuar ekipit të arkeologëve që të kuptojnë se çka përmbante varreza para gërmimit. Në këtë mënyrë është mundësuar që eskavatori në mënyrë të sigurtë të drejtohet dhe heq dheun mbi grumbullin e kufomave të zbuluara me anë të testeve gjeofizike.





Figura 4:
Rezultatet e rezistencës. E ndihmuar në gërmimin e sigurt me makinë

35. Rreth 90% të mbetjeve mortore të 74 pjesëve janë gjetur me rrobe të prishura, dhe ekipi i arkeologëve nuk ka vërejtur asnjë të veshur me rrobe ushtarake. Gjatë gërmimit nuk është parë apo gjetur asnjë dëshmi e lidhjeve të duarve apo syve. Vëzhgimi i arkeologëve ka shprehur mundësinë që shumica e kufomave brenda kësaj varreze kanë qenë të varrosura më parë dhe si pasojë e kësaj janë ekshumuar, transportuar dhe janë rivarrosur përsëri në BA 07, dhe për këtë arsye është vështirë të definohet se a është kjo varrezë primare apo varrezë sekundare. Dëshmitë kryesore për këtë veprimtari janë vëzhgimet, incizimet dhe marrja e mostrave nga tri lloje të ndryshme të dheut, mundësisht nga lokacionet origjinale të varrimit të gjetura brenda kësaj varreze.

BA07 N-S Profile



36. Katër palë dokumente të rëndësishme për identifikim të supozuar ishin gjetur në shtresa të ndryshme përbrenda varrezës. Tri palë prej tyre ishin gjetur së bashku me kufomat, ndërsa njëri dokument ishte gjetur brenda në dheun e varrezës. Gjërat tjera personale përfshijnë një palë teshpih, dhe dy 'Sim'™ kartela për telefona celularë.
37. Përveç mostrave të dheut, janë marrur edhe dy mostra të materialit bimor. Po ashtu, nga varreza është nxjerrë edhe një sasi e madhe e pjesëve të kamionit, përfshirë edhe materiale izolimi, një derë, dhe panele për të cilat besohet që janë pjesë të kamionit me ftohje.

38. Sikurse edhe në varrezat dhe elementet paraprake, ekipi i arkeologëve ka zbuluar dhe regjistruar dëshmitë e aktiviteteve të makinës për ndërtim dhe kamionit, në formë të shenjave të gomave dhe dhëmbëve të lugës së makinës përbrenda varrezës.

10. Batajnica 8 (BA 08)

10.1. Përmbledhje e gjetjeve

39. BA 08 nuk është varrezë. Ashtu si BA 06, kjo është një zonë në të cilën ka pasur djegje intenzive. Nga ky lokacion janë gjetur gjithsej pesë pjesë të kufomave, të gjitha me shenja të djegjeve.

10.2. Gërmimi

40. Gjatë heqjes së kontrolluar të dheut në jug të BA 07, është identifikuar një element në formë të çrregullt me dimensione rreth 4m me 2.60m. Mbetjet e skeletuara mortore me shenja të djegjeve janë gjetur në pjesën verilindore të këtij elementi, e po ashtu janë regjistruar edhe copë të rrobeve, drunjëve, telave të gomës, pllaka të keramikës dhe gëzhoja plumbi. Të gjitha këto dëshmi tregojnë si pasojë e ekspozimit ndaj zjarrit.
41. Brenda zonës së djegur janë gjetur dy gropa të cekëta; një gropë e vogël e cekët në pjesën veri-lindore të zonës në të cilën janë gjetur pjesa më e madhe e mbetjeve mortore, dhe një gropë më e madhe e cekët në pjesën juglindore të zonës. Nga sipërfaqja e gërmuar, thellësia maksimale e gropës më të madhe të cekët, ishte rreth 0.30m. Shenjat e gomave të makinave në sipërfaqen origjinale tregojnë që të paktën dy makina kanë qenë në veprim gjatë ose menjëherë pas zjarrit. Gjurmët e dhëmbëve të lugës së makinës për ndërtim tregojnë se një makinë kishte vepruar në këtë zonë për të ngritur gjësendet, si duket për ti vendosur në njërin nga varrezat e hapura në atë vend.

10.3. Përpunimi i mbetjeve mortore

42. Autopsitë e mbetjeve të gërmuara mortore janë procesuar në vendin e ngjarjes nga anëtarë të IML-së sipas urdhërave të Gjykatës së Qarkut të Beogradit. Një tendë e madhe ushtarake ishte vendosur në fund të zonës së policisë anti-terroriste (SAJ), në një distancë të vogël prej varrezave masive dhe elementeve që lidhen me to. Patologët mjeko ligjorë të IML-së kanë kryer autopsitë në të gjitha kufomat dhe në pjesët e kufomave që janë nxjerrur nga varrezat dhe elementet. Gjërat e selektuara nga mbetjet mortore mandej janë dorëzuar tek antropologët mjeko ligjorë për të bërë vlerësimin e gjinisë, gjatësisë trupore, dhe moshës. Për secilin rast është bërë raport i kombinuar që përmbante edhe të gjeturat patologjike edhe ato antropologjike. Këto raporte individuale i mban Gjykata e Qarkut e Beogradit. Vëzhguesve të ICMP-së u ishte lejuar që t'i shqyrtojnë këto raporte në vendin e ngjarjes, mirëpo ICMP-së nuk i'u lejua që të mbajë ndonjë kopje për dosjet e veta.

10.4. Aktivitetet e ICMP-së rreth autopsive

43. ICMP-ja nuk kishte në dispozicion patolog mjeko ligjorë për të vëzhguar autopsitë. UNMIK-u ka qenë i kontaktuar dhe i ftuar që poqëse ka dëshirë të dërgojë një patolog shqiptar nga Kosova për të vëzhguar autopsitë. Asnjë përfaqësues nga UNMIK-u nuk ishte i pranishëm gjatë autopsive.
44. ICMP-ja nuk kishte siguruar antropolog mjeko ligjorë për të monitoruar ekzaminimet; megjithatë, antropologët kishin lëvizur gjatë gërmimeve nëpër lokacione, ku kishin ndihmuar ose kishin kryer gërmimet, dhe kishin bërë kontrollime të kohë pas kohshme në tendën ku kryheshin ekzaminimet. Pasi që roli primar i ICMP-së ishte që të ndihmojë gjatë gërmimeve, dhe në ekzaminimet e limituara në tendën për ekzaminime, fokusimi më i madh i antropologëve të ICMP-së ishte kryesisht në varrezat dhe elementet. Nga vëzhgimet e antropologëve të ICMP-së në tendën për ekzaminime, e tërë puna është

kryer në mënyrën më të mirë të mundshme duke marrë parasysh kushtet e punës në tenda pa ujë të rrjedhshëm.

10.5. Ruajtja e kufomave

45. Pas ekzaminimit, të gjitha mbetjet mortore dhe rrobet e gjetura janë ruajtur në një vend në varg tunelesh. Është bërë një regjistër se ku është vendosur secila mbetje mortore në tunele (për vitin 2002).

10.6. Mostrat e eshtrave

46. Siç u cek më parë, në pajtim me normat ligjore, procesi i ekshumimit bie nën jurisdikcionin e Gjykatës së Qarkut të Beogradit. Në bazë të marrëveshjes së nënshkruar midis Qendrës Koordinuese për Kosovë dhe ICMP-së, e cila ishte ripërtirë me shkëmbim letrash, gjykatësi hetues i ka dhënë ICMP-së mostrat e eshtrave për analiza të ADN-së.
47. Mostrat e eshtrave nga BA 01 dhe BA 02 janë transferuar në Qendrën Koordinuese për Identifikim të ICMP-së më 21 qershor të vitit 2002; mostrat nga BA 03 më 6 shkurt të vitit 2003; BA 05 më 21 qershor të vitit 2003; dhe BA 07 dhe BA 08 më 7 tetor të vitit 2003.